

ÇFARË PËRFAQËSON?

SELIA, KOMPETENCAT TOKËSORE DHE KONTAKTET

1 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, e riorganizuar, ushtron veprimtarinë gjyqësore e administrative me seli në qytetin e Tiranës dhe kompetencë tokësore, që përfshin rrethet gjyqësore Tiranë, Durrës, Shkodër, Kukës, Dibër, Elbasan, Lezhë dhe Korçë.

2 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë mban të njëjtin emërtim pas datës 01.07.2023.

3 Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër ndërpresin veprimtarinë më datë 30.06.2023.



Adresa e Gjykatës: Rruga
“Ibrahim Pashë Bushatlliu”

Kontakte:

✉ info.administrativetirana@gjykata.gov.al

☎ 04 244 7088



GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË TIRANË

CILAT JANË ORGANET E ADMINISTRIMIT
GJYQËSOR?

- **Këshilli i Gjykatës**
- **Kryetari/
Zëvendëskryetari**
- **Kancelari**

TRANSFERIMI DHE MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË TIRANË

ÇËSHTJET GJYQËSORE QË TRANSFEROHEN NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË TIRANË

Çështjet gjyqësore të regjistruara në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Durrës, Korçë dhe Shkodër deri në datën 30.06.2023, por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit, transferohen në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të riorganizuar.

Çështjet gjyqësore të transferuara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë **nuk** i nënshtrohen rindarjes me short elektronik. Këto çështje vijojnë të shqyrtohen nga i njëjti trup gjykues.

ÇËSHTJET GJYQËSORE **NUK** RINDAHEN ME SHORT

Numri i gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është 27 gjyqtarë.

Strukturat e shërbimeve gjyqësore të përbëra nga Kryesekretari dhe Sekretarët Gjyqësorë mbështesin drejtpërdrejt veprimtarinë gjyqësore të gjykatës.

Strukturat e shërbimeve administrative, të tilla si: buxheti dhe financa, teknologjia e informacionit, burimet njerëzore dhe protokolli/arkivi, etj., janë përgjegjëse për mirëfunksionimin e veprimtarive administrative të gjykatës.

Zyrat e Shërbimeve Durrës, Korçë dhe Shkodër ngrihen dhe funksionojnë pranë godinave të ish-Gjykatave Administrative Durrës, Korçë dhe Shkodër, të riorganizuar, për të ofruar shërbime administrative që lidhen me protokollin dhe arkivin gjyqësor.